



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Procesverbalit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari Nr.12-320-16918 të datës 23.04.2020 ,duke vendosur sipas kërkesës së Naser Thaqit nga Sllovia, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM  
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro), Naser Thaqit nga Sllovia , sipas kërkesës së tij të datës 21.04.2020 për ta mbështetur financiarisht dhe kompensuar njëkohësisht për dëmin e shkaktuar nga të ftohtit dhe bora ku i janë dëmtuar shumë fidane në serrën e tij konform Procesverbalit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari Nr. 12-320-16918 të datës 23.04.2020.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në xhironlogarinë bankare 13000090000211689 në BPB.

**Neni 3**

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjellë dëshmi-faturë dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Naser Thaqi nga Sllovia.

1Nr. 320-16918  
Lipjan, më 14.05.2020

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

